



**MINISTRIA E MBROJTJES E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

---

**DIREKTIVA E MBROJTJES 2022**

## Hyrje

Mjedisi strategjik sot karakterizohet nga epoka e konkurrencës strategjike ku agresiviteti i kërcënimeve tradicionale ndërthuret me kërcënimet e reja hibride, mjedisore, teknologjike dhe të informacionit, duke shkaktuar sfida dhe shqetësimë serioze të sigurisë. Rajoni i Ballkanit Perëndimor, pavarësisht se është në rrugën e integrimit euroatlantik, mbetet i brishtë dhe nën presione të vazhdueshme të jashtme, edhe si rezultat i influencës dhe ndikimit në rritje të Rusisë dhe Kinës. Republika e Shqipërisë, pavarësisht sigurisë që i jep statusi i të qenit vend anëtar i NATO-s, nuk është imune ndaj rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë. Këto tendencia pritet të vazhdojnë dhe potencialisht do të theksohen si rezultat i pandemisë të shkaktuar nga COVID-19. Për t'ju përgjigjur rreziqeve dhe kërcënimeve dhe dinamikave të paparashikueshme të mjedisit të sigurisë kërkohet informacion në kohë dhe i besueshëm, bashkëveprim midis strukturave të sigurisë dhe zbulimit, zhvillim i teknologjisë përmes mbrojtjen e informacionit, kapacitete bashkëkohore dhe diplomaci ushtarake aktive.

Viti 2021 ishte një vit i rëndësishëm për Shqipërinë, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura. Ne siguruam mbrojtjen e qytetarëve tanë, bashkëpunuam me aleatët dhe partnerët përmes parandalimin e konflikteve dhe adresimin e sfidave të përbashkëta, drejtuam përgjigjen kombëtare në përballimin e emergjencave civile, si dhe mbështetëm përgjigjen ndaj pandemisë. Ne jemi krenarë dhe mirënjohës të të gjithë personelit ushtarak dhe civil në Forcat e Armatosura, që punuan pa u lodhur në shërbim të kombit.

Viti 2022 do të vijojë të jetë sfidues dhe kërkon përshtatje të vazhdueshme të politikës sonë të mbrojtjes, aftësive dhe strukturës së forcës, të cilat do të na mundësojnë përballje edhe me situata të paparashikueshme.

Ne do vijojmë transformimin në mënyrën se si operojmë, në drejtim të garantimit të sigurisë dhe mbrojtjes së vendit, mbrojtjen e interesave tona euroatlantike, angazhimin në mënyrë proaktive në operacione ndërkombëtare, mbështetjen e qëllimeve tona të politikës së jashtme, si dhe sigurimin e aftësive dhe mbështetjes në raste të jashtëzakonshme.

Në këtë drejtim, rezultatet e punës përmes vitit 2022, me të cilat do të matet suksesi ynë, përfshijnë:

- Përmirësimin e trajtimit financiar, kushteve, kujdesit shëndetësor përmes ushtarakët dhe familjet e tyre, si dhe integrimin e tyre në shoqëri pas daljes në rezervë;
- Modernizimin, përmes pajisjes së Forcave të Armatosura me kapacitetet e nevojshme përmes përballuar me sfidat e ardhshme;
- Edukimin dhe arsimimin, duke konsoliduar reformën në Akademinë e FA-së, si dhe duke filluar projektet përmes Akademi dhe Kolegji Mbrojtjeje të standardeve të larta;
- Zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitetë dhe situatat emergjente, si dhe fuqizimin e kapaciteteve të specializuara të mbrojtjes civile në Forcat e Armatosura;
- Kontributin proaktiv në operacione dhe angazhime rajonale;
- Sigurinë kibernetike të sistemeve tona ushtarake;
- Rritja të aftësive të mbrojtjes, nëpërmjet teknologjisë dhe inovacionit.

Si ministër i Mbrojtjes jam i sigurt se strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura do të realizojnë me sukses objektivat e planifikuar, duke ofruar angazhimin maksimal në jetësimin e këtyre projekteve të rëndësishme, përmes vendin dhe shoqërinë.

Niko Peleshi

MINISTËR I MBROJTJES I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

# FUSHAT KRYESORE TË VEPRIMTARISË PËR VITIN 2022

## 1. Kuadri konceptual në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes.

Të rishikohet Plani Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2016-2025 (PAZHFA), duke hartuar PAZHFA 2022-2031, i cili mbështetur në drejtimet e identikuara në Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes 2019, të përcaktojë strukturën e ardhshme të Forcave të Armatosura (FA), kapacitetet dhe aftësitë e kërkua të përm bushjen e misionit dhe detyrave ligjore, si dhe përbashjen e detyrimeve në kuadër të Aleancës.

Gjithashtu, të fillojë procesi i rishikimit të Planit të Mbrojtjes, në linjë me dokumentet strategjike kombëtare dhe të Aleancës, përfshirë Konceptin e Mbrojtjes dhe *Deterrencës* të Zonës Euroatlantike.

## 2. Mirëmenaxhimi dhe zhvillimi i burimeve të mbrojtjes.

**2.1. Burimet njerëzore, rekrutimi dhe promovimi:** Të rishikohen politikat social-ekonomike, me synim përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të jetesës, punës dhe shërbimit, rritjen e përkujdesjes dhe krijimin e lehtësirave të tjera për personelin ushtarak dhe familjet e tyre, si dhe krijimin e të gjitha mundësive për integrimin e ushtarakëve në shoqëri, pas daljes në rezervë. Të materializohet rritja e sheshtë e pagës në nivelin 30% për ushtarakët dhe 6% për personelin civil në FA, si dhe trajtimi me bonuse për punonjësit e fushës së IT-së dhe të sigurisë kibernetike, si dhe specialiteteve të veçanta.

Të përmirësohet sistemi i rekrutimit, duke mundësuar që FA-ja të kenë kontakte më të drejtpërdrejta dhe të jenë më atraktive për të rinjtë. Rekrutimi të mbështetet në promovimin e FA-së dhe vlerave që ato mbartin dhe të zhvillohet në bashkëpunimin me pushtetin lokal dhe institucionet arsimore, bazuar në nevojat aktuale dhe të perspektivës.

Perspektiva gjinore të jetë pjesë e politikave dhe planeve, jo vetëm në përfaqësim, por edhe në përgjegjësi. Të vazhdojë ruajtja e përfaqësimit të femrave në uniformë në rekrutim dhe promovim, përgjatë gjithë strukturës së FA-së.

## 2.2. Arsimimi, trajnimi dhe stërvitja.

**Arsimimi:** Të vijojë transformimi i sistemit të Arsimit të Lartë Ushtarak (ALU), si pjesë integrale e arsimit të lartë kombëtar, bazuar në përvojën e akademisë së West Point-it (SHBA). Fokusi kryesor të jetë binjakëzimi me Akademinë West Point, akreditimi institucional, si dhe rritja e efektivitetit në të gjitha nivelet. Gjithashtu, të finalizohet projekt i kampusit të ri të Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA).

Të vijojë ngritja dhe funksionimi i Kolegjit të Lartë të Mbrojtjes në gjuhën angleze, me fokus dhe dimension rajonal, i cili do të shërbejë si një institucion i ALU profesional për të gjitha kurset e karrierës, deri në nivelin strategjik.

**Trajnimi:** Programi i trajnimit individual dhe kolektiv kombëtar të vijojë sipas standardeve kombëtare dhe atyre të NATO-s, me fokus rritjen e aftësive individuale dhe kolektive të personelit, shtabeve dhe trupës, duke integruar programin trajnues të FA-së me programin trajnues të NATO-s dhe programet e trajnimit individual të Komandës Amerikane në Evropë.

**Stërvitja:** Do të vijojë të jetë prioritet për rritjen e aftësive dhe kapaciteteve operacionale të FA-së, në përbashjen e misionit kushtetues, realizimit të Nivelit të Ambicies (LoA) dhe të angazhimeve në misionet dhe operacionet e OKB-së, NATO-s dhe BE-së, si dhe në operacionet brenda vendit në përballim të emergjencave civile dhe në operacione të kërkim-shpëtimit. Me qëllim rritjen e ndërveprueshmërisë, programi stërvitor i FA-së dhe stërvitjet e kompaktësimit të zhvillohen, bazuar në skenar real, duke e integruar me programet dhe konceptet *Deterrence and Defence of the Euro-Atlantic Area* dhe stërvitjet e përbashkëta të NATO-s, si dhe ato të Komandës Amerikane në Evropë.

Gjatë vitit 2022, fokusi kryesor të jetë përgatitja dhe zhvillimi i stërvitjes certifikuese të Grup-Batalionit të Lehtë të Këmbësorisë, sipas sistemit të vlerësimin “NATO CREVAL”, stërvitja e përbashkët me palën amerikane në poligonin e Bizës, zhvillimi i infrastrukturës mbështetëse stërvitore në garnizonin Zall-Herr, në Vaun e Dejës, në garnizonin e Poshnjës, si dhe zhvillimi i infrastrukturës me simulim në garnizonin Zall-Herr dhe në Departamentin e Simulimit në AFA.

Prioritet të jetë pjesëmarria në stërvitjet e “*Defender Europe 22*” jashtë vendit me disa nga kapacitetet operacionale dhe planëzimi për zhvillimin në vendin tonë të “*Defender Europe 23*”.

**2.3. Burimet materiale:** Të përdoren në mënyrë efektive dhe eficiente për të siguruar gatishmérinë dhe operacionalitetin e kapaciteteve të FA-së dhe në mënyrë të veçantë të formacioneve prioritare.

Të zhvillohen projekte dypalëshe, shumëpalëshe e rajonale, për pajisjen e FA-së me kapacitetet e nevojshme, si dhe për riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve, duke shfrytëzuar mundësitë për kosto më të ulëta dhe bashkëpunim për produkte të përbashkëta.

Të sigurohet mbështetja logistike (materiale) e përditshme dhe për operacionet e FA-së brenda vendit, mbështetja e trupave që angazhohen në misione/operacioneve jashtë vendit. Të përmirësohen më tej masat e sigurisë dhe ruajtjes përmes investimeve në infrastrukturë.

Kapacitetet e riparimit dhe mirëmbajtjes së teknikës së mjeteve tokësore, detare dhe ajrore të synojnë vendosjen në funksion të plotë të qendrave të riparimit e mirëmbajtjes. Të eksplorohen të gjitha mundësitë për zhvillim të projekteve dypalëshe, shumëpalëshe e rajonale, për pajisjen e FA-së me kapacitetet e nevojshme, si dhe për riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve.

**2.4. Mbështetja shëndetësore:** Të synohet zhvillimi dhe rritja e mëtejshme e kapaciteteve shëndetësore parandaluese dhe trajtuese me synim sigurimin e mbështetjes shëndetësore bazë e të detyrueshme të personelit. Të sigurohet mbështetja shëndetësore për trupat në nivel taktik, operacional dhe strategjik, si shërbimi mjekësor parandalues, klinik, laboratorik dhe farmaceutik. Prioritet të jetë angazhimi i personelit mjekësor të FA-së, në mbështetje të përgjigjes kombëtare në kuadër të masave parandaluese dhe përballuese për situatën e shkaktuar nga COVID-19, si dhe mbështetja për personelin e FA-së që merr pjesë në operacione dhe emergjencë civile.

**2.5. Burimet financiare:** Buxheti i Mbrojtjes të planifikohet në mënyrë të balancuar ndërmjet kategorive të shpenzimeve buxhetore, duke synuar zhvillimin e kapaciteteve dhe në përputhje me objektivat për rritje të transparencës dhe luftës kundër korruptionit, duke synuar rritjen e efektivitetit të shpenzimeve. Fokusi do të jetë në trajtimin e personelit, si dhe vazhdimësinë e mbështetjes së projekteve të investimeve, në përbushje të prioriteteve kryesore për vitin 2022, në kuadër të modernizimit të FA-së, mbrojtjes civile dhe angazhimeve ndërkombëtare.

### 3. Mbështetja me bazë ligjore.

Të vijojë rishikimi i legjislacionit vendas në fushën e mbrojtjes dhe përshtatja ligjore me legjislacionin evropian. Prioritet të jetë procesi i hartimit të projektakteve ligjore/nënligjore, lidhur me finalizimin e dokumenteve strategjike kombëtare, rishikimit të statusit të ushtarakut, përmirësimi të vlerësimit dhe ecurisë në karrierë të personelit ushtarak në FA, rekrutimin e kandidatëve për oficerë në FA, jetësimin e projektit të NATO-s në Bazën Ajrore Kuçovë, si dhe rezervat materiale të shtetit.

### 4. Zhvillimi i kapacitete të Forcave të Armatosura.

Zhvillimi i kapaciteteve të FA-së të orientohet nga përbushja e misionit kushtetues dhe detyrimeve ligjore, si dhe në përbushje të LoA të Aleancës dhe kërkesave të mbrojtjes kolektive, duke u fokusuar në zhvillimin e kapaciteteve dhe përbushjen e kërkesave të paketës së Objektivave të Kapaciteteve.

**4.1. Modernizimi:** Modernizimi i FA-së do të fokusohet në zhvillimin e kapaciteteve të kërkuara për zhvillimin e Grup-Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë, krijimin e kapaciteteve të komunikimit të dislokueshme e statike, si dhe zhvillimin e kapaciteteve të mbrojtjes kibernetike. Të vijojë modernizimi sipas planeve për Forcën Tokësore, Forcën Ajrore, Forcën Detare dhe Komandën Mbështetëse.

- *Forca Tokësore:* Në bashkëpunim me partnerët strategjikë do të vijojë kompletimi me mjete të blinduara, projekti i blerjes së armatimit të lehtë të këmbësorisë, mjetet e transportit dhe speciale, pajisje për mbështetjen xheniere të luftimit, pajisje individuale dhe kolektive për MADM, si dhe pajisje komunikimi taktik.
- *Forca Ajrore:* Projekti më i rëndësishëm në kuadër të infrastrukturës është ndërtimi i Bazës Ajrore Taktike të Kuçovës, si bazë taktike e NATO-s. Do të vijojë projekti për pajisjen me helikopterë "Black Hawk", kompletimi i dy helikopterëve "Cougar" (AS 532) me sisteme elektronike të vetëmbrojtjes dhe komunikimit, konsolidimi i kapaciteteve të vëzhgimit, zbulimit dhe monitorimit të Hapësirës Ajrore dhe zhvillimi i kapaciteteve të mbrojtjes ajrore të bazuar në tokë.
- *Forca Detare:* Do të vijojë modernizimi i sistemit të integruar të vëzhgimit të Hapësirës Detare, projekti për Sistemin Ushtarak për Menaxhimin e Mesazheve për anijet e klasit "Iliria" dhe qendrat operacionale, si dhe blerja e municioneve për Sistemet Automatike të Zjarrit 20mm për anijet e klasit "Iliria".
- *Komanda Mbështetëse:* Kompletimi i Kompanisë EOD me pajisje speciale/kolektive dhe me mjete speciale taktike luftimi/operimi, me pajisje për riparimin dhe mirëmbajtjen, si dhe me pajisje për monitorimin e mjedisit dhe analizimin e agjentëve CBRN. Projekti i Muzeut të FA-së në Bërzhitë, në funksion të promovimit të historisë së ushtrisë shqiptare dhe kulturës ndër vite.

**4.2. Gatishmëria dhe Operacionaliteti:** Të sigurohet gatishmëria e FA-së, në përbushjen e misionit kushtetues dhe detyrimeve në interes të Aleancës, duke siguruar pavarësinë, tërësinë territoriale dhe rendin kushtetues, si dhe duke rritur angazhimin në komunitet.

Të sigurohet përbushja e angazhimeve të FA-së për pjesëmarrje në operacionet ndërkombëtare, si dhe plotësimi i detyrimeve në kuadrin e Aleancës. Njësitë dhe repartet të kompletohen dhe mbështeten sipas prioriteteve, me fokus në njësitë e deklaruara në NATO.

**4.3. Ndërveprueshmëria:** Rritja e ndërveprueshmërisë si në nivel kombëtar, ashtu edhe me vendet e Aleancës, do të jetë në fokusin e aktiviteteve stërvitore dhe zhvillimin e kapaciteteve, bazuar në konceptet e NATO-s.

Procesi i standardizimit të mbështesë prioritetet dhe planet e modernizimit, duke përzgjedhur për ratifikim dhe implementim dokumentet e standardeve të NATO-s që mbështesin prioritetet e FA-së, paketën e Objektivave të Kapaciteteve dhe ato që konsiderohen kritike nga Aleanca, në kuadër të ndërveprimit. Prioritet të jetë ratifikimi dhe implementimi i doktrinave kryesore të Aleancës nga strukturat e FA-së, veçanërisht nga repartet e GBLK-së, për t'i paraprirë certifikimit të tij.

**4.4. Teknologja dhe Inovacioni:** Mbrojtja do të kontribuojë në zhvillimin e shoqërisë sonë përmes mbështetjes më të gjerë të inovacionit të teknologjisë në FA dhe në ekonomi, duke investuar në kërkim dhe zhvillim dhe në teknologji të reja, për të zhvilluar aftësitë ushtarake të mbrojtjes civile dhe sigurisë kibernetike. Në këtë drejtim, të përçohet një proces vlerësimi që bazohet në situatën aktuale të brendshme institucionale, por edhe në aspektin kombëtar, me synim nxitjen dhe mbështetjen e inovacionit dhe kërkimit shkencor, në dobi të zhvillimit të mbrojtjes, por edhe atij social-ekonomik. Të ndiqen proceset për zhvillimin dhe miratimin e zgjidhjeve teknologjike, për të adresuar nevojat tona ushtarake dhe angazhimin e Shqipërisë në Përshtypjesin e Inovacionit të Mbrojtjes për Atlantikun e Veriut (DIANA).

## **5. Mbrojtja kibernetike.**

Të punohet në drejtim të garantimit të sigurisë kibernetike të sistemeve ushtarake, nëpërmjet mbrojtjes së infrastrukturave të informacionit, fuqizimin e mjeteve teknologjike dhe ndërtimin e një mjedisit të sigurt kibernetik, me kapacitetet e këruara profesionale në fushën e sigurisë së informacionit.

Të zhvillohen mekanizmat e nevojshëm për sigurinë e informacionit në hapësirën kibernetike, duke përfituar nga përparësitetë e teknologjisë së informacionit, si dhe nxitjen e bashkëpunimit kombëtar e ndërkombeitar në fushën e sigurisë kibernetike.

Njësia Ushtarake e Sigurisë Kibernetike, në bashkëpunim me partnerët strategjikë, të arrijë kapacitetet e plota operacionale të saj.

## **6. Konsolidimi i Sistemit të Mbrojtjes Civile.**

Sistemi i Mbrojtjes Civile të synojë zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitetë, sigurimin e jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mbrojtjen e mjedisit. Prioritet është miratimi i akteve nënligjore, si dhe hartimi dhe zbatimi i dokumenteve strategjike për mbrojtjen civile. Të vijojë plotësimi i objektivave, për përbushjen e kushteve në kuadër të anëtarësimit në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile Evropiane, si dhe për ngritjen e Qendrës Kombëtare të Trajnimit për Mbrojtjen Civile. Të koordinohet dhe të mbështeten njësitet e qeverisjes vendore, për përmirësimin e investimeve në infrastrukturë, në kuadër të masave parandaluese dhe lehtësuese, për dëmet që mund të shkaktohen nga fatkeqësitetë.

## **7. Angazhimi dhe bashkëpunimi ndërkombeitar.**

**7.1 Bashkëpunimi ndërkombeitar:** Bashkëveprimi në kuadrin ndërkombeitar, të nisë nga roli ynë në kontekstin e NATO-s, bashkëpunimi me aleatët e ngushtë, si dhe synimet strategjike dhe objektivat parësore të politikës së jashtme të Shqipërisë. NATO-ja dhe BE-ja kanë nisur një proces të përshtatjes strategjike, në kuadrin e së cilës kontributi kombëtar të jetë i lidhur ngushtësisht dhe thelbësisht nga përqasja e fortë atlantike, që ka vendi ynë.

NATO është dëshira mbetet pika jonë thalbesore e referencës, për sa i përket vlerave të përbashkëta, parandalimit, *deterrencës* dhe mbrojtjes. Ministria e Mbrojtjes të mbetet e përkushtuar për të mbështetur përshtatjen e Aleancës, ndaj rreziqeve e sfidave aktuale dhe të ardhshme të sigurisë, duke mbajtur një qasje gjithëpërfshirëse, e cila merr në konsideratë të gjitha llojet e kërcënimeve, në çdo sferë dhe në të gjitha drejtimet strategjike, me fokus krahun jugor, si zona me interes strategjik kombëtar.

Ky vit do të jetë intensiv për NATO-n, pasi në Samitin e Madridit do të miratohet “Koncepti i Ri Strategjik”, zbatimi i të cilit do të ketë impakt për mënyrën se si do të mbrohem, zhvillohem, parandalojmë krizat, përshtatemi ndaj zhvillimeve të reja teknologjike, si dhe në bashkëpunimin ndërkombeitar.

Prioritet të jetë mbështetja dhe plotësimi i të gjitha detyrimeve në funksion të zhvillimit të kapaciteteve kombëtare, angazhimeve në aktivitetet, misionet dhe operacionet ndërkombeatore, rritja e ndërveprueshmërisë dhe bashkëpunimit me vendet anëtarë të NATO-s, BE-së, rajonit dhe atyre partnere.

Vëmendje e veçantë të jepet në drejtim të detyrimeve dhe angazhimeve që vijnë nga statusi i Republikës së Shqipërisë, si vend anëtar i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Rajoni i Ballkanit të mbetet prioritet edhe në angazhimet dypalëshe dhe shumëpalëshe, dhe në mënyrë të veçantë të vijojë mbështetja e gjithanshme dhe pa kufizime për Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës dhe konsolidimin e Forcës së Sigurisë së saj.

**7.2 Bashkëpunimi rajonal:** Të vijojë kontributi aktiv në iniciativat rajonale dhe të synohet nxitja e bashkëpunimit, për konsolidimin e sigurisë, stabilitetit dhe paqes në Evropën Juglindore. Në këtë

bashkëpunim të mbahet në konsideratë qëllimi i këtyre nismave rajonale, si ruajtja e paqes dhe stabilitetit, integrimi euroatlantik dhe promovimi i bashkëpunimit rajonal, të cilat janë dhe prioritetet e politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë.

Nëpërmjet bashkëpunimit ushtarak rajonal të synohet gjithashtu, nxitja e krijuar dhe përdorimit të kapaciteteve të përbashkëta ushtarake, kapaciteteve për përballimin e emergjencave civile, por edhe krijimin dhe përdorimin e kapaciteteve të përbashkëta në operacione ndërkombëtare.

**7.3 Kontributi ndërkombëtar:** Synim kryesor të jetë mbajtja e një roli aktiv jashtë kontekstit kombëtar dhe në operacionet për rivendosjen e stabilitetit ndërkombëtar, pasi mbrojtja e Shqipërisë fillon jashtë kufijve tanë territorialë dhe se qasja më efektive është parandalimi.

Të rivlerësohet përfaqësimi në strukturat e Aleancës, si dhe në misionet dhe operacionet ndërkombëtare, me qëllim rritjen e kontributeve. Në kontributet e FA-së në angazhime ndërkombëtare, të kërkojmë të arrijmë një peshë në varësi të ndërveprimit dhe karakteristikave tona, duke marrë parasysh vlerën e shtuar të misioneve të ndryshme dhe duke i kushtuar vëmendje të veçantë, mjedisit të afërt rajonal.

Për Bashkëpunimin për Siguri, të mbështeten iniciativat e Aleancës në forcimin e partneriteteve, si dhe të kontribuohet në fushën e armë-kontrollit dhe çarmatimit.

## 8. Komunikimi strategjik.

Të harmonizohen përpjekjet e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm, si faktor i rëndësishëm për zhvillimin e një identiteti të përbashkët dhe të një imazhi të dëshiruar për Mbrojtjen. Të arrihet komunikimi i të gjitha audiencave të mundshme të misionit dhe veprimtarisë së Mbrojtjes, në përputhje të plotë me zbatimin dhe mbrojtjen e interesave strategjikë. Të reduktohen përpjekjet për keq/disinformim dhe narrativat, që janë në kundërshtim me interesat strategjikë të vendit tonë, duke nën vizuar rëndësinë dhe efektet pozitive të përbushjes së këtyre interesave.

## PËRFUNDIME

Në zbatim të kësaj direktive, kërkoj nga të gjitha strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura, të hartojnë plane, programe dhe projekte të orientuara nga prioritetet dhe drejtimet e punës, si dhe të marrin të gjitha masat për realizimin e tyre në kohë e me cilësi, duke zbatuar mësimet e nxjerra për eliminimin e mangësive, përshtatjen dhe suksesin në zbatimin e Direktivës së Mbrojtjes 2022.